



## LETËR E PËRBASHKËT

**KRYEMINISTRIT TË SHQIPËRISË**  
Z. Edi RAMA

**KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS**  
Z. Albin KURTI

**MINISTRIT TË DREJTËSISË SË SHQIPËRISË**  
Z. Ulsi MANJA

**MINISTRES SË DREJTËSISË SË KOSOVËS**  
Znj. Albulena HAXHIU

### UNIONIT NDËRKOMBËTAR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË

Z. Marc SCHMITZ, President  
Z. Jos UITDEHAAG, Zëvendëspresident

**TË DASHUR KRYEMINISTRA TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS,**

**TË NDERUAR MINISTRA TË DREJTËSISË TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS,**

Urojmë të lexoni dhe mirëkuptoni çfarë po dërgojmë të shkruar, ne Përmbarduesit Gjyqësorë Privatë të Shqipërisë.

Problemet dhe pamundësitë me të cilat ndeshemi në ushtrimin e detyrës dhe profesionit tonë janë të shumta, të shumëfishuara në Shqipëri nga viti 2019 e këtej: Tërmeti (2019), Pandemia (2020-2022), Lufta (Ukrainë-Rusi, 2022).

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe zbatimi i drejtësisë së dhënë në letër, duke e jetësuar atë në interes të ekonomisë, shoqërisë e qytetarit, këto kohë po kthehet në një mision gati të pamundur. Jo vetëm nga rrethanat e jashtëzakonshme që po përjeton çdo profesion dhe individ, por edhe nga vetë qeveritë – ministrinë tona.

Guxojmë ta pohojmë këtë në emër të të dyja organizatave, Dhomës së Shqipërisë dhe Odës së Kosovës, të paktën për një fakt konkret.

Legjislacioni në fushën e përmbardimit privat, në të dyja anët e kufirit, është reformuar, huazuar dhe përshtatur pothuajse 100% sipas praktikës më të mirë evropiane-perëndimore. Ligjet respektive, si ligji nr. 04/l-139 “Për procedurën përmbardimore” në Kosovë dhe ligji nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat” në Shqipëri, janë miratuar me asistimin direkt të ekspertizës së njëjtë franko-holandeze, misionit EURALIUS dhe të UIHJ-së (Unioni Ndërkombëtar i Përmbarduesve Gjyqësorë).

Por të dyja ligjet, si në Kosovë ashtu dhe në Shqipëri, nuk janë zbatuar nga të dyja ministrinë përkatëse në një element tejet të rëndësishëm, që për ne është themelor: nxjerrja e akteve nënligjore për veprimtarinë dytësore/plotësuese të përmbauesit privat.

Ligji nr. 04/1-139 “Për procedurën përmbaimore”, miratuar që në vitin 2013 nga Kuvendi i Kosovës, parashikon në nenin 344 nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse nga ministri i Drejtësisë për kryerjen e aktiviteteve si, “mbledhja e detyrimeve nga të tretët”, e ashtuquajtur veprimtaria “collection”, apo bërja e konstatimit të fakteve “konstatimi” nga përmbauesi privat.

Për 9 vite me radhë, Ministria e Drejtësisë së Kosovës nuk gjeti as kohën dhe as vullnetin t’i miratonte këto akte!

Ligji nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimore gjyqësor privat”, miratuar në korrik 2019 nga Kuvendi i Shqipërisë, parashikon në nenin 2 “Fusha e zbatimit” veprimtarinë dytësore, që kryhen nga përmbauesi gjyqësor privat si, “kryerja e njoftimit të akteve”, “kryerja e mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim”, “konstatime të fakteve” dhe “kryerja e shitjes së sendeve në ankand publik me kërkesë të të interesuarve”.

Për 2 vite e 8 muaj të plotë, Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë nuk gjeti as kohën, as vullnetin për të miratuar këto katër akte!

- Përse në të dyja anët e kufirit, qeveritë tona refuzojnë të zbatojnë ligjin, kur vetë janë protagonistë të miratimit të tij?
- Përse në të dyja anët e kufirit, aktivitetin “collection” që ligji autorizon përmbauesin ta kryejë, qeveritë tona lejojnë ta kryejnë barakat financiare anonime, pa licencë dhe jashtë çdo kontrolli shtetëror?
- A është kjo një neglizhencë burokratike apo interesa të errët të natyrës financiare favorizojnë mosrespektimin e standardit ligjor evropian në vendet tona?

Kjo letër drejtohet për vëmendje dhe me pyetje shtesë edhe për Organizatën Ndërkombëtare që na përfaqëson, UIHJ-në, veçanërisht për dy drejtuesit kryesorë të saj:

Të dashur drejtues të UIHJ-së,

- A është normale kjo që ndodh në Shqipëri dhe Kosovë, sa i përket “harresës” disavjeçare qeveritare, për të mos lejuar që përmbauesit t’i shërbejnë Publikut, Ligjit dhe Ekonomisë?

Ju lutemi dhe në pritje të një reagimi ndërkufitar, por edhe ndërkombëtar, duke uruar që përgjigjja ndërministrare të mos vonojë edhe më shumë, për zbatimin e ligjit në të dy vendet tona, ju urojmë punë të mbarë ministrave dhe kryeministrave të Shqipërisë dhe Kosovës!

**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
SHQIPËRI - TIRANË**

**21 MARS 2022**